



Mus-e Kosova

## UDHËZUES PËR APLIKIM NË PROGRAMET E ERASMUS + NË AKTIVITETE TË EDUKIMIT JO FORMAL



*Ky udhëzues është përgatitur nga OJQ Mus-e Kosova me mbështetje të Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në Kosovë. Qëndrimet e reflektuara janë përgjegjësi e OJQ Mus-e Kosova dhe asesi e Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.*





## **UDHËZUES PËR APLIKIM NË PROGRAMET E ERASMUS + NË AKTIVITETETË EDUKIMIT JOFORMAL**

*Ky udhëzues është përgatitur nga OJQ Mus-e Kosova për të lehtësuar informacionin për organizatat rinore rreth aplikimit të Erasmus+ në Kosovë. Të gjitha informatat janë grumbulluar, përpunuar dhe thjeshtëzuar duke shfrytëzuar informacionin zyrtar për Erasmus + me qëllim të lehtësimit për aplikime në programet Erasmus+ për organizatat rinore në Kosovë.*

## PËRMBAJTJA

5	PROGRAMI ERASMUS+ DHE SOLIDARITY CORPS 2021-2027
5	PËRFSHIRJA DHE DIVERSITETI
6	TRANSFORMIMI DIXHITAL
7	MJEDISI DHE LUFTA KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
7	PJESËMARRJA NË JETËN DEMOKRATIKE
8	OBJEKTIVAT E PROGRAMIT ERASMUS+
9	STRUKTURA E PROGRAMIT ERASMUS+
9	KEY ACTIONI (KA1) – LËVIZSHMËRIA E INDIVIDËVE
10	PROJEKTET QË MBËSHTETËN NË KUADËR TË KA1
12	KEY ACTION 2 - BASHKËPUNIMI NDËRMJET ORGANIZATAVE DHE INSTITUCIONËVE
12	MUNDËSITË PËR ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE NË KUADËR TË KA2
15	KEY ACTION 3 – MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM TË POLITIKAVE
16	SI ZBATOHEN AKTIVITETET NË KUADËR TË ERASMUS+
17	SI TË APLIKOJMË PËR PROGRAMET ERASMUS+
18	KAPACITETET FINANCIARE
18	NJOHJA E KOMPETENCES - YOUTHPASS
19	REFERENCAT

Erasmus+ është program i Bashkimit Evropian që mbështet edukimin, trajnimet, rininë dhe sportin në Evropë.

Buxheti total i programit Erasmus+ për periudhën 2021-2027 është 26.2 miliardë euro<sup>1</sup>, buxhet ky gati dyfish më i lartë se i periudhës paraprake (2014-2017).

Programi për periudhën 2021-2027 e vendos fokusin në përfshirje sociale, agjendën e gjelbër dhe tranzicionin digjital, dhe promovon **pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike**.

### FUSHAT PRIORITARE TË ERASMUS+

Fushat prioritare të Erasmus + janë:

Përfshirja dhe Diversiteti

Transformimi Digjital

Agjenda e Gjelbër

### PËRFSHIRJA DHE DIVERSITETI

Organizatat dhe pjesëmarrësit me më pak mundësi dhe qasje janë në qendër të këtyre objektivave. Kjo komponentë targeton organizatat të cilat kanë një qasje më gjithëpërfshirëse duke mundësuar pjesëmarrjen për një gamë të ndryshme të pjesëmarrësve. Agjencitë kombëtare hartojnë plane për gjithëpërfshirje dhe diversitet. Qendrat Burimore, siç është ajo SALTO në Slloveni, mbështesin zbatimin e programit. Kjo komponentë ka për qëllim që të sigurohet se të gjitha grupet e marginalizuara, të kenë qasje në këtë program, dhe të jenë përfitues.

Lista e barrierave të mundshme të përshkruara më poshtë kanë për qëllim të sigurojnë ndërmarrjen e veprimeve për gjithëpërfshirje për grupet si më poshtë:

**Aftësia e Kufizuar:** Pjesëmarrje e barabartë pa marrë parasysh dëmtimeve fizike, mendore dhe intelektuale të cilat në ndërveprim me barrierat e ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen efektive të dikujt në aktivitete.

**Problemet Shëndetësore:** Pjesëmarrje e barabartë pa marrë parasysh çështjet shëndetësore duke përfshirë sëmundjet e rënda, sëmundjet kronike, ose çdo situatë tjetër të lidhur me shëndetin fizik ose mendor që pengon pjesëmarrjen në program.

**Barrierat e lidhura me sistemet e edukimit dhe trajnimit:** Pjesëmarrje e barabartë për të gjithë individët (njerëz që nuk kanë ndjekur shkollim, punësim ose trajnim), dhe të rritur me aftësi të ulëta që mund të përballen me barrierat e ndryshme

<sup>1</sup> <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/about-erasmus/what-is-erasmus>

. Edhe pse faktorë të tjerë mund të luajnë rol, vështirësitë e ndryshme arsimore mund të lidhen edhe me rrethanat personale, që kryesisht vijnë nga një sistem arsimor i cili krijon kufizime strukturore dhe/ose nuk merr plotësisht parasysh nevojat e veçanta të individit.

**Dallimet kulturore:** Pjesëmarrje e barabartë pa marrë parasysh çdo prejardhje kulturore që mund t'iu krijojnë individëve të caktuar më pak mundësi, siç janë emigrantët, atyre që i përkasin një pakice kombëtare apo fetare. Dallime të tilla kulturore madje mund t'i parandalojnë pjesëmarrësit potencialë që të aplikojnë për mbështetje përmes programit, duke përfaqësuar kështu një pengesë hyrjeje krejtësisht.

**Barrierat sociale:** Vështirësitë e përshtatjes shoqërore, siç janë kompetencat e kufizuara shoqërore, sjelljet antisociale ose me rrezik të lartë, shkelësit e ligjit, (ish)abuzuesit e drogës ose alkoolit, ose marginalizimi social mund të përfaqësojnë një pengesë. Barrierat të tilla që paraqesin pengesa për pjesëmarrje.

**Barrierat ekonomike:** Pjesëmarrje e barabartë pa marrë parasysh disavantazhin ekonomik si standardi i ulët jetese, të ardhurat e ulëta, nxënësit që kanë nevojë të punojnë për të mbajtur veten, varësia nga sistemi i mirëqenies sociale, papunësia afatgjate, situatat e pasigurta ose varfëria, të qenit të pastrehë, në borxhe ose probleme me financa, etj. Barrierat të tilla nuk duhet të jenë pengesë për pjesëmarrje.

**Diskriminimi:** Pjesëmarrje e barabartë pa marrë parasysh gjininë, moshën, përkatësinë etnike, fenë, besimet, orientimin seksual, paaftësinë ose faktorët ndërsektorial, ose (një kombinim i dy ose disa prej pengesave të përmendura diskriminuese).

**Barrierat gjeografike:** Pjesëmarrje e barabartë pa marrë parasysh nëse jetoni në zona të largëta ose rurale, në ishuj të vegjël ose në rajone periferike/më të jashtme, në periferi urbane, në zona më pak të qasshme (transport publik i kufizuar, objekte të dobëta), ose zona më pak të zhvilluara në vendet e treta, etj. Barrierat e tilla nuk duhet të jenë pengesë për pjesëmarrje.

## TRANSFORMIMI DIXHITAL

Pandemia Covid-19 edhe një herë na tregoi rëndësinë për transformim dixhital që i duhet Evropës. Nevoja për shfrytëzimin e teknologjisë u rrit shumë për mësimdhënie e mësim-nxënie, dhe nevojë për të zhvilluar aftësitë dixhitale për të gjithë. Kjo komponentë synon të mbështesë këtë përpjekje për të angazhuar nxënës, edukatorë, punonjës të rinj, të rinj dhe organizata në rrugën drejt transformimit dixhital. Kjo komponentë mbështetë veprimet që synojnë rritjen e aftësive dixhitale dhe zhvillimit të kompetencave në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe për të gjithë (përfshirë të rinjtë me më pak mundësi, studentë, punëkërkuar dhe punëtorë). Fokusi do të jetë në nxitjen e aftësive bazë dhe të avancuara dixhitale, i cili është bërë thelbësor për jetën e përditshme dhe për aftësimin e njerëzve për të lundruar në një botë plot algoritme dhe për të marrë pjesë plotësisht në shoqërinë civile dhe demokracinë.

## MJEDISI DHE LUFTA KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Veprimet mjedisore dhe klimatike janë prioritetet kryesore për BE-në tani dhe në të ardhmen.

Ky program do të jetë një instrument kyç për ndërtimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve mbi ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si brenda Bashkimit Evropian ashtu edhe më gjerë. Programi Erasmus+ do të rrisë numrin e mundësive për rritjen e qëndrueshme të planetit tonë, me vëmendje të veçantë në zonat rurale si zhvillimi, bujqësia e qëndrueshme, menaxhimi i burimeve natyrore, mbrojtja e tokës. Për më tepër, Erasmus+, promovon neutralizimin e karbonit dhe emetimit të gazrave.

Lufta kundër ngrohjes globale do të bëhet përmes zhvillimit të kompetencave në sektorë të ndryshëm të qëndrueshmërisë mjedisore, përfshirë ato në kuadrin e kontributit nga arsimit dhe kultura në qëndrueshmëri, qëllimet e zhvillimit, zhvillimin e strategjive dhe metodologjive të aftësive sektoriale të gjelbra, kurrikula të orientuara drejt së ardhmes që plotësojnë më mirë nevojat e individëve, si dhe nismat që mbështesin qasjet e planifikuara të organizatave pjesëmarrëse në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore.

Programi mbështet përdorimin e praktikave inovative për t'i bërë të rinjtë faktorë të vërtetë të ndryshimit (p.sh. kursimi i burimeve, reduktimi i përdorimit të energjisë dhe mbeturinave, kompensimi i emetimeve të gjurmës së karbonit, zgjedhja e ushqimit të qëndrueshëm dhe zgjedhjeve të lëvizshmërisë, etj. Prioritet do t'i jepet gjithashtu projekteve që përmes edukimit, trajnimit, aktiviteteve rinore dhe sportive, mundësojnë ndryshime në sjellje për preferencat individuale, vlerat kulturore dhe ngritjen e vetëdijes për zhvillimin e qëndrueshëm, zakonet e konsumit dhe stilin e jetës.

**Organizatave dhe pjesëmarrësve duhet të përfshijnë praktikën e gjelbra në të gjitha projektet dhe aktivitetet në kuadrin e Erasmus+.**

## PJESËMARRJA NË JETËN DEMOKRATIKE

Programi **Erasmus+** trajton pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në proceset demokratike dhe mungesën e njohurive për Bashkimin Evropian. Forcimi i njohurive për BE-në mbetet thelbësor. Përveç arsimit formal, mësimi joformal mund të rrisë kuptueshmërinë e qytetarëve për Bashkimin Evropian dhe të nxisë ndjenjën e përkatësisë në të.

Programi trajton pjesëmarrjen e kufizuar të qytetarëve në proceset e tij demokratike dhe mungesën e njohurive të tyre për Bashkimin Evropian, dhe përpiqet t'i ndihmojë ata të kapërcejnë vështirësitë në angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive në komunitetet e tyre ose në jetën politike dhe sociale të Unionit. Forcimi i të kuptuarit të qytetarëve për Bashkimin Evropian që në moshë të re është thelbësor për të ardhmen e Bashkimit. Fokusi është vënë në rritjen e kuptueshmërisë të kontekstit të Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje me vlerat e përbashkëta të BE-së, parimet e unitetit dhe diversitetit, si dhe trashëgiminë e tyre shoqërore, kulturore dhe historike.

Programi ka këto objektiva të veçanta:

- **Promovimi i shkëmbimeve mësimore të individëve dhe grupeve, përmes bashkëpunimit, promovimit të barazisë dhe nxitjes së kreativitetit dhe inovacionit në nivel të organizatave dhe politikave në fushën e arsimit dhe trajnimit.**
- **Promovimi i edukimit joformal dhe pjesëmarrjes aktive mes të rinjve përmes: bashkëpunimit, përfshirjes, kreativitetit dhe inovacionit në nivel të organizatave dhe politikave në fushën e rinisë.**
- **Promovimi i shkëmbimeve mësimore të stafit sportiv, si dhe bashkëpunimit, kreativitetit dhe inovacionit në nivel të organizatave sportive dhe politikave sportive.**



## STRUKTURA E PROGRAMIT ERASMUS +

Në cilat Veprime Kyçe (Key Actions) organizatat nga Kosova mund të marrin pjesë si organizata partnere dhe si aplikant direkt?

### KEY ACTION I (KAI) – LËVIZSHMËRIA E INDIVIDËVE

Veprimi Kyç I (KAI) ku organizatat nga Kosova mund të jenë vetëm partner të organizatave nga BE, dhe nuk mund të jenë aplikues direkt mbështet këto aktivitete.

Ky Veprim Kyç mbështet:

**Shkëmbimet e stafit dhe studentëve:** Mundësi për shkëmbime për nxënës, studentë, dhe të rinjë, si dhe për profesorët, mësuesit, trajnerët, punonjësit e të rinjve, trajnerët e sportit, stafi i institucioneve arsimore, dhe organizatave të shoqërisë civile për të shkëmbyer një përvojë mësimore dhe/ose profesionale në një vend tjetër;

**Pjesëmarrja e të rinjve:** Ky veprim mbështet nisma lokale dhe transnacionale të drejtuara nga të rinjtë, grupe joformale të rinjve dhe/ose organizata rinore për të ndihmuar të rinjtë të angazhohen dhe të mësojnë të marrin pjesë në jetën demokratike, duke rritur vetëdijen për vlerat e përbashkëta dhe të drejtat themelore të Bashkimit Evropian. Po ashtu përmes kësaj komponentë synohet bashkimi i të rinjve dhe vendimmarrësve në nivel lokal, kombëtar dhe evropian, si dhe duke kontribuar në qëllimet e përbashkëta të Bashkimit Evropian.

**Aktivitetet ‘Zbulo BE-në’:** Veprim që u ofron të rinjve 18-vjeçarë mundësinë për të pasur një herë të parë, afatshkurtër, përvojë individuale ose grupore duke udhëtuar në të gjithë Evropën në kuadër të një aktiviteti arsimor joformal që synon nxitjen e ndjenjës së tyre të përkatësisë në Bashkimin Evropian dhe zbulimin e diversitetit të tij kulturor (**aktivitet vetëm për shtetet e BE-së**).

Programi ofron mundësi të mësimit të gjuhës për pjesëmarrësit që kryejnë një aktivitet mobiliteti jashtë vendit.

## PROJEKTET QË MBËSHTETËN NË KUADËRTË KAI

### DETAJE PËR SHKËMBIME RINORE

#### Partneriteti:

Minimumi 2 partnerë  
nga shtete të ndryshme

#### Kohëzgjatja e projektit dhe kohëzgjatja e aktivitetit:

Projekti nga 3-24 muaj.

Aktiviteti nga 5-21 ditë (përveç ditëve të udhëtimit)

#### Mosha e lejueshme:

13-30- vjeç

Liderët duhet të jenë të paktën 18 vjeç ose dhe me tepër

#### Numri i pjesëmarrësve që mund të përfshihen:

Min. 16 dhe max. 60 pjesëmarrës

Liderat ose persona të tjerë shoqërues nuk përfshihen

#### Minimumi i pjesëmarrësve në grup:

Min. është 5 (4+1 lider)

## Detaje Kryesore: Trajnime, seminare, vizita studimore

### Partneriteti:

Minimumi 2 partnerë  
nga shtete të ndryshme

### Kohëzgjatja e projektit dhe kohëzgjatja e aktivitetit:

Projekti nga 3-24 muaj.

Aktiviteti nga 2-60 ditë (përveç ditëve të udhëtimit)

### Mosha e lejueshme:

S'ka limit moshe

### Numri i pjesëmarrësve që mund të përfshihen:

Max. deri në 50 pjesëmarrës

### Kritere të tjera:

Të paktën një organizatë duhet të jetë nga vendi ku aplikohet projekti

## KEY ACTION 2 (KA2) - BASHKËPUNIMI NDËRMJET ORGANIZATAVE

### DHE INSTITUCIONEVE

#### Partneritetet për Bashkëpunim, duke përfshirë:

**Partneritetet e Bashkëpunimit:** Qëllimi kryesor i Partneriteteve të Bashkëpunimit është të lejojë organizatat të rrisin cilësinë dhe rëndësinë e aktiviteteve të tyre, si dhe për të zhvilluar dhe përforcuar rrjetet e tyre të partnerëve. Aspekt i rëndësishëm është ngritja e kapaciteteve duke rritur ndërkombëtarizimin e organizatave, nëpërmjet shkëmbimit ose zhvillimit të praktikave dhe metodave të reja, si dhe shkëmbimit dhe përbaljes së ideve.

**Partneritetet në shkallë të vogël:** Ky veprim synon të zgjerojë qasjen në program për aktorët e shkallës së vogël dhe individë që janë të vështirë për t'u arritur në fushat e arsimit shkollor, arsimit të rriturve, arsimit profesional. Përmes shumave të vogla të parave, kohëzgjatjes më të shkurtër të aktiviteteve dhe kërkesave administrative më të thjeshta, ky veprim synon të arrij organizatat më me pak përvojë duke zvogëluar barrierat administrative

#### Partneritetet për Përsosmëri, duke përfshirë:

**Universitetet Evropiane:** Ky veprim mbështet shfaqjen e rrjeteve të arsimit të lartë nga poshtë-lartë dhe institucioneve, të cilat përmes zhvillimit do ta çojnë bashkëpunimin ndërkufitar në nivelin tjetër - të ambicies të strategjive të përbashkëta afatgjata për arsimin, kërkimin dhe inovacionin me cilësi të lartë, bazuar në një vizion dhe vlera të përbashkëta

**Qendrat për Përsosmëri Profesionale:** Kjo nismë mbështet zhvillimin e platformave trans-nacionale të qendrave të përsosmërisë profesionale të integruara ngushtë në strategjitë lokale dhe rajonale për rritje, inovacion dhe konkurrueshmëri, duke mbështetur ndryshimet e përgjithshme strukturore dhe politikat ekonomike në Bashkimin Evropian.

**Erasmus+ Akademitë e mësuesve:** Objektivi i përgjithshëm i këtij veprimi është krijimi i partneriteteve evropiane të ofruesit e edukimit dhe aftësisë të mësuesve për të krijuar Akademitë e Mësuesve Erasmus+ që do të ofrojnë një perspektivë ndërkombëtare në edukimin e mësuesve.

## MUNDËSITË PËR ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE NË KUADËR TË KA2

**Projekte për ngritjen e kapaciteteve në fushën e rinisë:** Ky veprim mbështet bashkëpunimin dhe shkëmbimin në fushën e rinisë ndërmjet organizatave të vendeve të programit ku hyjnë vendet e BE-së dhe vende jashtë BE-së, sic janë (Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia, Turqia, Islanda dhe Norvegjia, dhe Litenshtajn) si dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duke e përfshi Kosovën.

Në kuadër të kësaj komponente, organizatat nga Kosova mund të aplikojnë drejtpërdrejtë

për projekte për të zhvilluar aktivitete në Kosovë duke bërë partneritet me organizatat nga vendet e programit.

Në kuadër të këtij veprimi organizatat mund të aplikojnë për aktivitete të edukimit joformal me fokus:

- Ngritja e kapaciteteve të organizatave që punojnë me të rinjë jashtë mësimi formal;
- Pjesëmarrje e të rinjve;
- Ngjarje sportive jofitimprurëse- përgatitja dhe organizimi i ngjarjeve sportive në vende të ndryshme.

Në kuadër të këtij veprimi, organizatat e shoqërisë civile nga Kosova së bashku me organizata partnere nga vende të ndryshme të BE-së dhe vendeve të Ballkanit, mund të aplikojnë për organizim të aktiviteteve në Kosovë, ose njëkohësisht mund të jenë organizata partnere për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara në shtetet e programit.

Në këtë grup hyjnë të gjitha llojet e aktiviteteve të edukimit joformal si trajnime, seminare, vizita studimore etj.

## DETAJE PËR APLIKIM NË KA2

### Partneriteti:

Minimumi 2 organizata partnere nga vendet e programit si dhe 2 nga vendet partnere (pra, 3 shtete dhe 4 organizata)

### Kohëzgjatja e projektit dhe kohëzgjatja e aktivitetit:

Projekti nga 12-24 ose 36 muaj.

### Buxheti:

Min. 100,000 EUR

Max. 300,000 EUR

### Financim:

Max. deri në 80%

### Kritere te tjera:

Vetëm një projekt propozim mund të dërgohet në një deadline (afat aplikimi)

### TË POLITIKAVE

Ky Veprim Kyç mbështet:

**Të Rinjtë Evropian së Bashku** - Ky veprim i synon organizatat rinore në nivelin bazë, të cilat duan të krijojnë partneritete përtej kufijve, gjegjësisht, ato organizata të cilat synojnë t'i shtojnë një dimension evropian aktiviteteve të tyre. Qëllimi është që të inkurajojnë aplikime të reja nga organizata që nuk janë tashmë të vendosura mirë në nivel evropian.

#### **Për më tepër, ky veprim mbulon:**

Veprimet që synojnë përgatitjen dhe mbështetjen e zbatimit të agjendës së politikave të BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, duke përfshirë axhendat sektoriale për arsimin e lartë, arsimin dhe aftësimin profesional, shkollat dhe të mësuarit e të rriturve, dhe në veçanti duke lehtësuar qeverisjen dhe funksionimin e Metodave të Hapura të Veprimet që synojnë mbledhjen e provave dhe njohurive rreth sistemeve të arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit dhe politikave në nivel kombëtar dhe evropian, me synimin për të lehtësuar politikë bërjen e arsyetuar. Mbledhja e provave dhe analiza do të ndërmerret nëpërmjet anketave dhe studimeve në mbarë BE-në apo në nivel ndërkombëtar, si dhe ato tematike dhe ekspertizë specifike për vendin.

Veprimet që nxisin dialogun e politikave me palët e interesuara brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian, nëpërmjet, konferencave, ngjarjeve dhe aktiviteteve të tjera që përfshijnë politikëbërës, praktikues dhe aktorë të tjerë në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit, për të rritur vetëdijen në lidhje me agjendat përkatëse të politikave evropiane dhe për të promovuar Evropën si një destinacion i shkëlqyer studimi dhe kërkimi.

## SI ZBATOHEN AKTIVITETET NË KUADËRTË ERASMUS+

Komisioni Evropian është autoriteti që zbaton aktivitete në kuadër të Erasmus+ në kuadër të agjencive nacionale që kanë zyret në secilin shtet të programit (Programe Countries).

Të gjitha shtetet e BE-së kanë zyret (Agjencitë Nacionale) dhe mund të shikohen këtu [National Agencies | Erasmus+ \(europa.eu\)](http://europa.eu).

Shtetet tjera që nuk janë (Shtete të Programit), si pikë kontakti kanë Zyrat Nacionale të Erasmus+. Zyra e Erasmus+ në Kosovë mund të vizitohet këtu <http://www.erasmuspluskosovo.org/>.


Shtetet të cilat nuk kanë një zyre nacionale, i aplikojnë projektet direkt tek agjencia EACEA që ndodhet ne Bruksel. Shtet që i quajmë shtete të programit, në varësi të Veprimit Kyç (Key Action) aplikojnë edhe direkt në EACEA ose në Zyrat Nacionale (National Agencies).



## SITË APLIKOJMË PËR PROGRAMET ERASMUS+

Për ta dorëzuar një aplikacion të Erasmus+, na duhet të jemi të regjistruar në platformën Erasmus+ and European Solidarity Corps. Ndërsa për European Solidarity Corps aplikohet po këtu por për t'u akredituar. Në momentin që merret akreditimi, organizata ka të drejtë të kordinoj, mirëpres dhe dërgoj vullnetarë në varësi të akreditimit që ka marrë.

(<https://webgate.ec.europa.eu/erasmus-esc/index/>).



The screenshot shows the homepage of the Erasmus+ and European Solidarity Corps portal. At the top, there is a navigation bar with the European Commission logo and the text 'Erasmus+ and European Solidarity Corps'. Below this is a main header with the text 'Welcome to Erasmus+ and European Solidarity Corps page!'. The page is divided into several sections: 'HOME', 'ORGANISATIONS', 'OPPORTUNITIES', 'PROJECTS', 'SUPPORT', and 'RESOURCES'. The 'OPPORTUNITIES' section is highlighted and contains two main cards: 'Erasmus+' and 'European Solidarity Corps'. Each card has a blue megaphone icon and a button labeled 'Opportunities'. The text on the page includes instructions on how to apply for actions supported by the Erasmus+ Programme or European Solidarity Corps, and provides links for more information and support.

Pasi të keni krijuar profilin e organizatës tuaj, ju do të merrni një kod unik identifikues (PIC CODE) dhe do të mund të aplikoni për projekte.

Vegëza në vazhdim tregon të gjitha hapat për të bërë regjistrimin e organizatës për herë të parë në portal:

[https://ec.europa.eu/research/participants/portal/doc/call/fp7/fp7-ict-2013-sme-dca/32991-obtaining\\_pic\\_and\\_ecas\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/research/participants/portal/doc/call/fp7/fp7-ict-2013-sme-dca/32991-obtaining_pic_and_ecas_en.pdf)

Pasi të krijoni profilin, ju duhet të shikoni nëse i plotësoni kriteret për aplikim dhe poashtu t'i shikoni kriteret që mund t'iu diskualifikojnë.

## KAPACITETET FINANCIARE

Në rast të kërkesave për grante të BE-së që nuk i kalojnë 60,000 EUR, aplikantët duhet të paraqesin një deklaratë nderi që vërteton se kanë kapacitetin financiar për të zbatuar projektin. Kjo deklaratë nderi përbën një pjesë të veçantë të formularit të aplikimit.

Në rast të kërkesave për grante të BE-së mbi 60,000 EUR dhe të dorëzuara nga lloje të tjera subjektesh nga ato të përmendura më sipër, aplikanti duhet të paraqes përveç deklaratës së nderit edhe dokumentet e mëposhtme nëpërmjet portalit të financimit dhe mundësive të tenderit/Sistemit të Regjistrimit të Organizatave:

- Llogaria e fitimit dhe humbjes së aplikantit;
- Bilanci i gjendjes për vitin e fundit financiar për të cilin janë mbyllur llogaritë;
- Dokumente të tjera, nëse kërkohen.

## NJOHJA E KOMPETENCES-YOUTHPASS

Youthpass është çertifikata që pjesëmarrësit përfitues nga aktivitetet e edukimit joformal e lëshojnë për të përmirësuar njohjen e rezultateve të nxëniet të rinjve dhe punonjësve rinorë nga pjesëmarrja e tyre në projektet e mbështetura nga Programi Erasmus+.

Youthpass përbëhet nga:

- a) Certifikata që mund të merren nga pjesëmarrësit në disa aktivitete të programit;
- b) Një proces i përcaktuar që mbështet të rinjtë, punonjësit rinorë dhe organizatat rinore për të reflektuar rreth rezultateve të nxëniet nga një projekt Erasmus+ në fushën e të rinjve dhe të mësuarit joformal.

Youthpass është gjithashtu pjesë e një strategjie më të gjerë të Komisionit Evropian, e cila synon të rrisë njohjen e të mësuarit joformal me të rinjtë në Evropë dhe më gjerë.

**Shënim:** Ne rekomandojmë që për çdo thirrje për projekte të lexohet guida e programit. Sigurohuni që jeni duke iu referuar versionit më të fundit. Guida ripublikohet në çdo moment që ka ndryshime në program. Çdo ndryshim pasqyrohet aty. Gjithashtu dëshirojmë t'iu informojmë që aplikimet bëhen vetëm online nëpërmjet portalit, kështu që iu sugjerojmë që mos ta lini aplikimin tuaj për në momentin e fundit duket qenë se mund edhe të ndodhin probleme teknike.

**Programme Guide Link:**

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/programme-guide\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/programme-guide_en)

**Distance Calculator:**

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/distance-calculator\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/distance-calculator_en)

**Registration of the Organizations:**

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/registration-organisations\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/registration-organisations_en)

**Platforms and Networks:**

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/platforms-networks\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/platforms-networks_en)

**Accreditation of the NGOs:**

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/calls/2020-erasmusaccreditation-youth\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/calls/2020-erasmusaccreditation-youth_en)

